



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SELENICË
NJËSIA E PROKURIMIT

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNE

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“BLERJE AUTOMJETE”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Automjete

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,300,000 lekë (tete milion e treqind mije) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, **Bashkia Selenice** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Argumentimi : Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe VKM Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit përcaktohet se në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Në përfundim të punës grupi u referua në nenin 76 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, pika

- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim;

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur për automjetet rezultoi vlera e përgjithshme e kontratës.

Afati i realizimit të është 1 (një) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kriteri (a) është vendosur ne baze te nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kriteri (b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar si dhe në ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të biznesit”, të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet te paraqesin vertetim per xhiron vjetore per vitet financiare **2021, 2022** dhe **2023**, ku vlera e xhiros per 3 (tre) vitet e fundit duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit te kontrates qe prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 shkronja c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet te paraqesin bilancet vjetore, per vitet financiare **2021, 2022**, dhe **2023**, te shoqeruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetem ne rastin kur jane ne kushtet e percaktimeve te *ligjit Nr.10 091, date 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve te njepasnjeshme, nuk duhet te kene raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285 datë 05.03.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar , si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.i cili parashikon se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha **detyrimet e taksave dhe tarifave vendore**, lëshuar nga Pushteti Vendor, **për vitin 2023 – 2024 ne te gjitha vendet ku ka**

ushtruar aktivitetin referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument në momentin e dorëzimit të dokumentave).

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore për vitin 2023, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar sipas të cilit operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrorjnë aktivitet, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të percaktuara nga cdo njësi e qeverisjes vendore, në Ligjin Nr. 9 920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin Nr. 131/2015 “Për QKB” i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr. 9 723, datë 03.05.2007 “Për QKR”, i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

punë të ngjashme për furnizimet e mëparshme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog original (ose kopje të noterizuar) ose fletëpalosje për automjetin që oferton, ku në katalogun përkatës të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, ku të gjejnë pasqyrim parametrat teknikë të produktit (shih specifikimet teknike). Për specifikimet teknike të kërkuara të cilat mund të mos jenë të pasqyruara në katalog OE duhet të paraqesë një deklaratë për plotësimin e tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162., datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 6 të VKM nr. 285., datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose kontratë bashkëpunimi me Servis të specializuar dhe të licensuar sipas rregulloreve të Republikës së Shqipërisë, për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale, akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB, etj dhe licensën përkatëse.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162., datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 5 të VKM nr. 285., datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Kjo kërkesë lidhet me detyrimin e kontraktorit që gjatë gjithë shtrirjes të garancisë së mjetit të jetë në gjendje të sigurojë suportin teknik dhe pjesët e ndërrimit sipas standartit teknik të përcaktuar nga prodhuesi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori i shoqërisë:

- a) që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së mjetit, prej jo më pak se 6 muaj.
- b) ku garanton kryerjen e shërbimeve motorrike dhe xhenerike për riparimin e automjeteve, gjatë periudhës së garancisë.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mallrat objekt prokurimi do të përmbushin kërkesat teknike dhe do të mbulohen të gjitha problematikat (defektet) që mund të lindin, jo për shkak të Autoritetit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë nga administratori i shoqërisë ku merr përsipër dorëzimin e mjeteve të treguara dhe regjistruara në pronësi të Bashkisë Selenicë, ku në çmim të jenë përfshirë të gjitha shpenzimet doganore, regjistrimi, targat, kolaudimi dhe siguracioni.

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 8 të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Vendosija e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjeti do të dorëzohet pranë AK i pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të Policisë së Shtetit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Bazuar në nenin 35 dhe 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 13 dhe 76 të V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, komisioni i ngritur “Për hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit”, ka hartuar dhe argumentuar specifikimet teknike.

Specifikimet teknike janë hartuar sipas kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor dhe kërkesave të bëra nga Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme.

Janë mbajtur parasysh standartet duke përshtatur nevojat e institucionit për një performance të lartë të tregut. Komisioni ka haruaratuar specifikime teknike të cilat të plotësojnë kërkesat e cilësisë dhe garancisë për një produkt cilësor i cili të jete konform nevojave për të cilin autoriteti do të perdore ato.

1. Viti i prodhimit:	Jo më herët se viti 2004
2. Kilometra të përshkuara:	Jo më shumë se 500,000 km
3. Fuqia e motorrit:	Minimumi 440 hp
4. Lënda djegëse:	Naftë
5. Akse:	8x4
6. Sistemi i frenimit:	ABS
7. Trasmisioni:	Manuale
8. Cilindra:	minimumi 6
9. KarrocERIA:	Vetëshkarkuese
10. Gjatësi totale e mjetit:	Minimumi 6 m
11. Gjerësi totale e mjetit:	Minimumi 2.3m
12. Numri i vendeve:	Minimumi 2
13. Peshëmbajtja totale:	Minimumi 36000 kg
14. Volumi:	20 m ³
15. Pozicionimi i timonit:	Krahu i majtë

Konkretisht për mjetin Kamion 4 aksial 20 m³ vetëshkarkues, grupi i punës i caktuar me urdher për hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike argumenton të specifikimet teknike se:

Pika 1- Për përcaktimin e vitit të prodhimit u bazua të buxheti dhe në studimit të tregut.

Pika 2- Kilometrazhi jo më shumë se 500,000 km për arsye se mjeti nuk është konsumuar, amortizuar shumë.

Pika 3-5- Kërkohej minimumi fuqia 440 hp për arsyen se mjetet në këto fuqi kanë rendiment më të lartë për ngarkesën e kërkuar, dhe akse 8x4 për një qendrueshmeri të lartë të mjetit një ballancim uniform të ngarkesës në terrene të vështira.

Pika 4- Për këtë procedurë për llojin e karburantit është zgjedhur lënda djegëse “Naftë”, për shkak se dallimi kryesor në mes të motorëve me naftë dhe me benzinë është efikasiteti termik që motorët me naftë kanë. Motorri me naftë është 20% më efikas sesa motorrat me benzinë, gjë që ndikon drejtpërdrejtë me rritjen e ekonomisë së karburantit në 20%. Arsye tjetër se përse për këtë procedurë është zgjedhur lënda djegëse “Naftë” është dhe tipologjia e mjetit. Duke qënë se janë mjete të rënda dhe janë të presupozuara të punojnë në terrene të vështira dhe kërkojnë një forcë motorrike të konsiderueshme është përzgjedhur lënda djegëse “Naftë” dhe për arsye të fuqisë kalorifike që ajo ka (më të lartë se benzina). Gjithashtu duke testuar edhe tregun përgjithësisht për mjetet e rënda lënda djegëse është “Naftë”. Motorri me naftë është më i thjeshtë, ka më shumë qendrueshmeri dhe jetëgjatësi më të lartë.

Pika 6- Sistemi ABS- Anti-lock Brake System ose në shqip sistemi që nuk e lejon gomën të bllokohet plotësisht. ABS na ndihmon në situatën e një frenimi të fortë ku në rastin e një makine pa abs goma do bllokohej 100% nga freni dhe mundësia për të manovruar me anë të timonit humbet totalisht duke qënë se goma nuk ka më aftësinë rrotulluese për të bërë të mundur drejtimin. Në rastin kur mjeti është i pajisur me sistemin ABS gjatë një frenimi të fortë ABS nuk na lejon që goma të bllokohet kjo i jep shoferit mundësinë që dhe të frenojë në maksimum por dhe të shmangët duke përdorur timonin.

Pika 7- Transmesioni manual është në mjetet e rënda ku këto transmesione kanë një përdorim të shumicës për shkak të efikasitetit të tyre të fillimit për të ngarkuar ose tërhequr një peshë me një shpejtësi të caktuar, të shoqëruara nga mbështetëse të tilla si një motor elektrik së bashku me një të ashtuquajtur konvertues çift rrotullues të dyfishtë, si dhe një motor frenues që mund të parandalojë dëmtimin e transmetimit në ndalesa të papritura. Transmesioni manual i garanton shoferit kontrollin

e plotë mbi marshin kur do të beje ndërrimet. Mjetet me transmesioni manual kushtojne me pak, edhe kane kosto me te ulet mirembajtje ne krahasim me mjetet me transmesion automatik.

Pika 8- Motorri me 6 cilindrata prodhon me shume fuqi/moment. Motorri ka punim te qete me pak zhurma ne kabine edhe eficence ne konsum.

Pika 9- KarrocERIA duhet veteshkarkuese per te lehtesuar punen dhe kursim kohe.

Pika 10-11- Permasat e mjetit i referohen plotesimit te kapacitetit mbajtes.

Pika 12- Minimumi 2 vende per arsye se duhet te kete edhe nje vend per nje ndihmes(shofer/punetor).

Pika 13-14- Minimumi i peshes 36,000 kg eshte vendosur per arsye te transportimit te kategorive te ndryshme te inerteve, per nje volum prej 20m³.

Pika 15- Pozicionimi i timonit duhet te jete i majte per tu pershtatur legjislacionit rrugor Shqiptar.

Shënim: Mjetet e përdorura (me kilometrazh/ore pune më shumë se 0):

Mjetet duhet të jenë në gjendje shumë të mirë motorike, xhenerike dhe vizuale në pjesën e brendshme/jashtme dhe duke mos pasur dëmtime sidomos për sa i përket korrozionit, dëmtimet nga agjentët atmosferikë, goditjet etj. Tubat e presionit te vajit, te jene ne gjendje te mire (te pa gripuara). Gomat te jene ne gjendje te mire (jo te konsumuara).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Person pergjegjes

Specialist i Fushes

Fondi Limit